



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Hani Elezit

**01/ Nr/24 /2011**  
**Data: 01/03/2011**

Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, mbështetur në Statutin e Komunës, Ligjin për Financat Lokale, Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 24.02.2011 merr këtë:

**VENDIM**  
**PËR**  
**BARTJEN E BILANCEVE TË PASHPENZUARA**

**I**

Lejohet bartja e bilanceve të pa shpenzuara nga të Hyrat Vetanake të Komunës nga viti 2009 dhe 2010 në buxhetin e vitit vijues 2011, në shumë prej **104,938.10 €**

**II**

Bilanci i mjeteve buxhetore të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të Komunës sipas pikës I të këtij vendimi, bartet në vitin buxhetorë 2011 në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje (shujta ditore për nëntë mujorin e vitit 2010), subvencione transfere si dhe në shpenzime kapitale, të prezantuara në tabelën 2 dhe 3 që do t'i bashkëngjiten këtij vendimi.

**III**

Ekzekutimin e këtij vendimi do ta bën Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**IV**

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit.

**V**

Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Ekonomisë dhe Financave - Departamenti i Buxheteve Komunale dhe Shërbimi i Arkivit.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**  
**Menduh Vlasi**



Të hyrat vetanake të vitit 2009 të cilat ka qenë të bartura në vitin 2010 ishin 140,253.15 € prej tyre janë shpenzuar 139,412.24 € shuma për bartje në vitin 2011 është 840.91 €.

Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2010 ishin 215,352.13 € prej tyre janë shpenzuar 111,254.94 €, për bartje në vitin 2011 janë 104,097.19 €, pra shuma totale e të hyrave për bartje është (840.91 + 104,097.19) 104,938.10 €

Zyra e Kryetarit dhe bordi i drejtorëve propozuan këtë shpërndarje të të hyrave vetanake: sipas

*Tabela nr. 2. Të hyrat vetanake të bartura në vitin 2011 dhe shpërndarja e tyre*

Kodi i Progr.	Programet Buxhetore	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfere	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
16035	Zyra e Kryetarit	1 247.40			24 000.00		25 247.40
16335	Administrata	7 900.20					7 900.20
17535	Buxhet dhe Financa	2 910.60					2 910.60
18439	Shërbime Publike	2 494.80					2 494.80
66480	Urbanizëm	2 494.80				56 174.90	58 669.70
75670	Shërbimet Sociale	831.60					831.60
92175	Adm.e Arsimi	831.60					831.60
94020	Arsimi Fillor	5 220.60					5 220.60
95220	Arsimi i Mesëm	831.60					831.60
	<b>Gjithsej</b>	<b>24 763.20</b>			<b>24 000.00</b>	<b>56 174.90</b>	<b>104 938.10</b>

*Tabela nr. 3. Bartja e mjeteve të pashpenzuara të vitit 2009 dhe vitit 2010 në vitin vijues 2011 .*

Nr	Nr i Projektit	Emri i Projektit	Shuma në €
1	Projekt i ri	Ndriçimi i pjesëve të zonës urbane në Han të Elezit	10,000.00
2	Projekt i ri	Rregullimi i rrugës prej lagjes së Krasniqëve deri te Sh. F. "Kështjella e Diturisë"	6,174.90
3	Projekt i ri	Dislokimi i trafos së qytetit	9,000.00
4	Projekt i ri	Kanalizimi i një pjese të Hanit të Elezit	11,000.00
5	Projekt i ri	Fond për shpronësim	20,000.00
6		Subvencione dhe Transfere	24,000.00
7		Paga dhe mëditje	24,763.20
	<b>Gjithsej</b>		<b>104,938.10</b>